VËLLEZËRIT VOSKOPOJARË, SI E RINDËRTOI BARONI SINA KATEDRALEN ORTHODOKSE TË VJENËS

NGA **Pjeter Logoreci** Faqe 20-21

Për zbukurimet e mbrendëshme dhe pikturat murale, Baroni Sina angazhoj piktorët më në zë të kohës Carl Rahl dhe Ludwig Thiersch, të cilët stolisën kishen sipas shijes dhe tematikes fetare të zgjedhur nga vetë Baroni Sina...



RILINDASI

Suplement i SHQIPTARJA.com

E diel
19 qershor 2016
Viti **VI** - Nr:**26**
e-mail: rilindasi@gmail.com

Kryeredaktore;
Admirina Peçi

Louis Lucien Bonaparte

Financimi i librave/ Pse duhet ti financonte e të përkujdesej për këto botime nipi i Napoleon Bonapartit? Pse në gjuhën shqipe?

NIPI I NAPOLEONIT

Përkthime shqip nën kujdesin e princit Bonaparti

NGA **Xhevat Lloshi**

Brenda tre vjetëve janë botuar në Londër tre përkthime shqip të Ungjillit të Mateut: Libri i parë më 1868 në arbërishten e Horës së Arbëreshëve; libri i dytë më 1869 në arbërishten e Frasnitës dhe libri i tretë më 1870 në gegërishten e Shkodrës. E përbashkëta e tyre është se janë bërë nën kujdesin e Princit Bonaparti dhe janë financuar e shtypur prej tij. Pyetja e parë që shtrohet atëhere është kjo: si shpjegohet ky interesim për gjuhën shqipe?

Lui-Lysien Bonaparti (Louis-Lucien Bonaparte,1813-1891) ishte djali i vëllait të dytë të Napoleon Bonapartit. Pothuaj gjysmën e parë të jetës e kaloi në Itali; fliste 5 gjuhë dhe lexonte në shumë të tjera. Me sa duket, vëmendja për gjuhët iu ngjall që nga viti 1839. Fushat kryesore të interesimeve gjuhësore të Bonapartit mund të mbahen dialektologjia dhe gjuhësia krahasuese. Veprat e para diturore në fushën krahasuese i botoi në Itali. Që më 1843 gjatë udhëtimeve nëpër Europë dhe gjithashtu me ndihmën e bashkëpunëtorëve mblodhi lëndën për librin e tij të parë Specimen lexici comparativi (Gjedhe leksikore krahasuese), që doli në Firence më 1847. Përmbante shembuj me fjalët si deus, spiritus, angelus etj. për krahasimin ndërmjet 52 gjuhëve, mes të cilave përmend edhe epirotishten.

VIJON NË FAQEN 16-17

KISHA E SHNA NDOIT, NJË HISTORI E RRALLË MES LEGJENDËS DHE FAKTEVE HISTORIKE

NGA **Kastriot Marku** Faqe 20-22

Kisha e Shën Antonit të Padovës në Laç të Kurbinit/ Nga legjendja e ndërtimit të saj prej fretërve françeskanë, tek historitë e rrënimeve e rindërtimeve në vitet 1600-1900... e deri në rrënimin e saj të plotë në periudhën komuniste...

KONTRIBUTI | HISTORIA

Vllezërit voskopojarë

Si e rindërtoi baroni Sina Katedralen Orthodokse të Vjenës

▶ **Në foto Theophil Hansen dhe pamje dhe skica të katedrales së Orthodokse e Trinisë Shenjte të Vjenës**

NGA **PJETER LOGORECI**

Për zbukurimet e mbrendëshme dhe pikturat murale, Baroni Sina angazhoj piktorët më në zë të kohës Carl Rahl dhe Ludwig Thiersch, të cilët stolisën kishen sipas shijes dhe tematikes fetare të zgjedhur nga vetë Baroni Sina...

Në mes të dhjetra objekteve të klasit të parë, që hyjnë në hartën e bukurive tërheqëse të Vjenës është dhe Katedralja Orthodokse e Trinisë Shenjte. Shumë pak njerëz e dijnë që, sponsorizuesi dhe iniciatori për rindërtimin dhe zbukurimi i këtij objekti të rëndësishëm të besimit orthodoks është biznesmeni miliarder Baroni Gjergj Sina dhe (pas vdekjes së tij) i biri Baroni Simon Sina, të ardhur në Vjenë nga Voskopoja e bukur. Dinastia e famëshme e baronëve vlleh Sina, të cilët iken nga tokat shqiptare që ndodheshin nën zotërimin osman, kishte një aktivitet të gjërë dhe pasuri të pakufi, të cilat përvec tregëtisë, i investoi në ndërtimin e infrastrukturës së Austrisë, duke ndërtuar linja të reja hekurudhash nga Hungaria deri në Trieste, si dhe në ndërtim objektesh, duke zbukuruar në veçanti pamjen e qytetit të Vjenës me ndërtimin e një sërë godinash socialkulturore, që sot janë me famë.

Për të zbatuar projektet e tij në infrastrukturën hekurudhore të monarkisë të Habsburgeve, Gjergj Sina, aktivizoj inxhinierin më në zë të kohës Karl Ghegën, ndërsa për realizimin e planeve në ndërtim, solli nga Athina arkitektin me famë botërore Theophil von Hansen.

Theophil Hansen, i lindur në Kopenhagë në qeshor të vjetit 1813, mbas mësimeve që mori në Vjenë nga mjeshtri Karl Schinkel, u shperngul në Athinë për të studiuar stilin grek të ndertimeve. Si punim i parë, gjatë periudhës 8 vjecare të qëndrimit të tij në Athinë, njihet Observatori i yjeve, por më pas pat dhe objekte të tjera të rëndësishme publike. Aty Hansen ra në kontakt me manjatin voskopojar, Baronin Gjergj Sina, i cili i mahnitur nga stili grek i ndërtimeve të Hansenit, e solli atë në Vjenë dhe e ngarkoj me ndërtimin e një sërë objektesh që ai financonte, ndër to edhe rindërtimin e kishës orthodokse të Trinisë Shenjte në Vjenë. Historia e rindërtimit të kishës madhështore fillon në vitin 1856, kur arkitekti dhe ndërtuesi Hansen u kontraktua nga baroni Sina për ta rindërtuar kishën egzistuese, që kishte permasa të vogla.

Deri atëherë kisha, që vjenezët e quanin "kisha greke", ishte objekt kulti për shërbesat fetare të grupeve të besimtarëve Vllehë dhe Grekë, të ikur nga trojet e pushtuara nga perandoria osmane, të cilët ishin orthodoks të ritit grek. Bashkësia e këtyre etnive që njihej zyrtarisht qysh në vitin 1781 dhe qe krijuar me lejen e Kaiserit Jozefi II-të, në vitin 1787 ndërtoj për nevojat e saje një kishë të vogël, po në vendin ku sot ndodhet katedralja. Ky objekt i vogël i kultit ishte vepër e ndërtuesit vjenez Peter Mollner. Kisha u ndërtua në qëndër të Vjenës, në bashkinë e parë me adresen Fleischmarkt 13, në vendin ku më parë gjindej pallati i familjes aristokrate të Kontave Stockhammërsche. Me dekret të Kaiserit Franc i II-të, u dha leja që të ndërtohej një kambanare ku të vendosej një sahat dhe këmbanat si dhe u lëjua rënia e tyre në oraret e caktuara me ligj.

Më vonë, në maj të vitit 1804, nga qeveria, u lejua hapja e një shkolle greke e cila u vëndos po në të njëjtën godinë me kishën dhe me hapsirat për banesat e klerikëve ortodoks të komunitetit, duke u përmbledhur kështu në famullinë e Trinisë Shenjte.

Me rritjen e numrit të besimtarëve u ndje



nevoja e një hapsire më të madhe dhe në vitin 1856, këshilli i kishës vendosi që të rikostruktojë kishën. Me mbështetjen financiare të Baronit Sina, arkitekti Teophil Hansen u ngarkua për realizimin e rindërtimit të objektit, por me përmasat e një katedraleje. Punimet ndërtuese për Katedralen zgjatën rreth dy vite dhe me 21 dhjetor 1858 u bë bekimi i saj. Arkitektura e pjesës kryesore është ndërtuar sipas stilit karakteristik barock të shumë faltoreve austriake, gjë që nuk ishte e zakonëshme për Hansen-in. Pozicioni i ndërtesës së vjetër, që kishte një fasadë të pjerrët dhe të ngushtë, si dhe ligji për ndërtimin e detyrueshëm të kishave sipas ritit katolik, i nxorën shumë vështirësi arkitektit Hansen, i cili i pat "duert e lidhura" për të realizuar idetë e tija. Megjithatë, Hansen u mundua që ambientet e mbrendëshme ti realizonte në stilin bizantin, gjë që shihet menjëherë në hapsirat e hyrjes. Fasaden e realizoj me tulla të kuqe dhe të verdha, ndërsa dyert, dritaret dhe kolonat në gur të bute (Sandstein). Kornizat dhe ornamentet e mrekullueshme janë nga material toni të pjekur, të praruara në ar, të realizuara nga fabrika e njohur Brausewetter.

Për zbukurimet e mbrendëshme dhe pikturat murale, Baroni Sina angazhoj piktorët më në zë të kohës Carl Rahl dhe Ludwig Thiersch, të cilët stolisën kishen sipas shijes dhe tematikes fetare të zgjedhur nga vetë Baroni Sina. Në pikturat murale të pjesës së hyrjes, punuan piktorët Bitterlich dhe Eisenmenger, që ishin nxënësit e Rahl-it.

Duke kërkuar nëpër arkivat austriake dokumente mbi Dinastine Sina dhe ndërtimin e katedrales, arrita të gjej një dosje e cila përmbante dokumentacion shkresor dhe skica origjinale të bëra nga vetë Hansen, për objektin e katedrales. Sipas një përshkrimi që gjindej në këtë dosje të bërë nga vetë arkitekti Theophil Hansen, shkruhet që shpenzimet kapen shumën 70 000 Gulde.

Duhet përmendur që, për të kryer varrimet e orthodoksve vlleh dhe grek të Vjenës, në vitin 1837, u ble një truall në vorrezën Sankt Marxer, që akoma sot njihet me emrin "sektori i varrezave të bashkësisë së ortodoksve grekë".

Që nga viti 1963, kisha e Trinisë Shenjte në Vjene, mori statusin e Katedrales së Metropolisë së Ortodoksve të ritit grek dhe përvec zyrave të metropolisë dhe shkollës, u krijua dhe biblioteka e bashkësisë. Pas projektit të ndërtimit të Katedrales, arkitekti Theophil Hansen, realizoj disa projekte të tjera ndërtimore, që sot janë pikante në Vjenë, të cilat u financuan nga vllehët voskopojar të familjes Sina dhe Dumba. Mund të përmendim këtu ndërtesën e parlamentit austriak (1883), ndërtesën e Shoqatës së Muzikantëve ku gjindet dhe Salla e Artë (shumë e njohur si salla e koncertit simfonik të vitit të ri) që u hap në 1870-tën.

Vjenë, me 15.6.2016





LIBRI I RI

"Një lexim i mundshëm i poezisë", format unik mbi poezinëbashkëkohore

Me një dashuri për poezinë refleksive, prof. Aliu është ulur këmbëkryq në vargje të autorëve të gjysmës së dytë të shek XX, për të mbërritur te më të rinjtë e fillimit të shek XXI

NGA **MAJLINDA NANA RAMA**

Një ndër përfaqësuesit e shquar të fushës së studimeve, apo "gjenerali", siç do ta quante profesor Alfred Uçi, është akademiku Ali Aliu.

Një gjysmëshekulli, profesor Aliu do të mbante lidhje të pandërprera me studimet letrare, duke na sjellë kohë të ndryshme, letërsi të ndryshme dhe autorë të ndryshëm. E sot, pas shumë vitesh pune e përkushtimi profesional, ai mbetet sërish zëri më ftillues, me pikë bazale atë të sigurimit të së ardhmes së letërsisë kombëtare. Si studiues i rëndësishëm i mendimit kritik, Aliu ka ditur të krijojë lidhje mes epokave krijuese, duke evidentuar vlerat më të mira të secilës epokë për t'ia sjellë lexuesit si modele. Sepse, të evidentosh një letërsi të talentuar në kohë të trazuara dhe ndryshimesh historike, është një mision i pandërprerë për një shërbim që i bëhet kombit, sidomos kur letërsia e kultura kombëtare duhen theksuar si dëshmi autentike kulturologjike. Jeta e studimore e prof. Ali Aliut në shkencat letrare, do të niste me "Kërkimet" në vitin 1971, për të mbërritur, pas më shumë se 40 veprash, te "Don Kishoti shqiptar" (ribotuar disa herë), vepra në të cilat Aliu vjen me qasje të veçanta depërtuese në tharmin krijues të autorëve.

Ali Aliu

Së fundmi, studiuesi vjen me librin "Një lexim i mundshëm i poezisë", një ribotim i plotësuar, i cili ka brenda formacionit të vet zgjedhje të një zinxhiri të mirëfilltë poetësh që kanë dëshmuar qëndrueshmëri e nivel krijues në këto dekada. Me një dashuri për poezinë refleksive, prof. Aliu është ulur këmbëkryq në vargje të autorëve të gjysmës së dytë të shek XX, për të mbërritur te më të rinjtë e fillimit të shek XXI, duke treguar se ka një letërsi kombëtare tej e përtej kufijve në progres të përditshëm.

I angazhuar në fatet e nëpërkëmbura të Kosovës, që rrethohej nga re të zeza tis, prof. Aliu sjell poetët më në zë të një letërsie që krijoi tempullin e memories si vlerë kombëtare, por edhe që u bë pararendëse e përmbysjes së paragjykimi vlerash të mohuara të racës shqiptare. Evidentimi, nxjerrja në dritë, shpluhurosja, qëndrimi krahë për krahë me këtë kastë autorësh, e bëri Ali Aliun faktor të rëndësishëm, jo vetëm në fushën e letrave, por edhe në zhvillimet shoqërore me ndikim historik në vend. Në optikën analizuese të kritikut janë përfshirë poetë të mëdhenj, si: Azem Shkreli e Ali Podrimja, të cilët fatin e tokës së tyre e mbanin me vete, "edhe në kohët më të vështira", siç thotë vetë studiuesipër Podrimjen. Por, një letërsi e mbyllur brenda territoreve gjeografike të një vendi, nuk bën gjë tjetër veç ngushtëson lirinë dhe hapësirat që kërkon të pushtojë arti i paanë i letërsisë dhe, në këto kushte, i bindur për misionin e bashkësisë si sistem letrar, Aliu do të zgjeronte lupën e tij hulumtuese, duke kapërcyer përmatanë brigjeve të Kosovës e Maqedonisë, deri në viset më të thella të letërsisë shqipe. Edhe këtë herë, ai depërton furishëm në zgrip të vargut të poetëve të shquar, si: Fatos Arapi, Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Bardhyl Londo, Xhevahir Spahiu, për të mbërritur tek autorët e rinj të kësaj letërsie. Aliu kërkon nëpër vargje të zbulojë shqetësimet e gjithëkohshme nëpër rrjedhat historike, duke trajtuar poezi që kanë në përmbajtje probleme sociale e shoqërore, jo vetëm si pjesë e sisteneve e ndryshimeve politike (socrealiste apo pluraliste), por edhe si gjendje ekzistenciale të shpirtit njerëzor e human.

Në këtë libër, prof. Aliu trajton, analizon dhe zbulon thelbin estetik të formëpërmbajtjes, duke u nisur nga parime tërësisht mbështetëse e dashamirëse, por me ligjësi të kthjellëta të dëshirës së përjetshme të paraqitjes së një letërsie traditore e bashkëkohore, simbiozë kjo që qendërzohet në spektrin shqyrtues të Aliut pothuaj në të gjithë udhëtimin e tij analitik. Siç rrëfen vetë studiuesi, përzgjedhja e poezive të përfshira në këtë libër nuk është bërë për qëllime antologjike, porse për të krijuar orë të hapura në auditore studentësh për një openmind të brezit të ri drejt poezisë bashkëkohore.

Libri "Një lexim i mundshëm i poezisë" bart me vete vlera të mendimit kritik, jo në kuadër të inventarizimit të mendimit teoriko-kritik-gjuhësor, por të një gjendjeje tjetër që, me një këndvështrim individual, ndriçon varg e fjalë të poetëve. Studiuesi depërton me një zbërthim ideor e tematik, si dhe mesazh universal për një shoqëri të bardhë. Kjo vepër studimore vjen me një konstruksion të fortë vlerësimesh shkencore e estetike mbi poezinë, duke u bërë e vetmja e këtij lloji në fushën e studimeve dhe kritikës letrare.

Në mbyllje, akademiku Ali Aliu vazhdon të mbetet modeli i studiuesit erudit me shpirt modest, por, siç do të shprehej Dostojevski: "Në kujtesën e popullit, mbetet vetëm ai të cilin populli e ka dashur". I tillë është edhe Aliu, njeriu e studiuesi, penës së të cilit nuk i tremben aspak krijuesit e rinj a të vjetër, por mësojnë prej kritikës së tij me forma alternative të gjuhës eufemike. Aliu ka fatin të jetë njëri nga heronjtë kumbues, pra, që letërsisë së poetëve e shkrimtarëve i jep mbështetje dhe nuanca të jashtëzakonshme letrare.